



Aleanca për
Media
Etike

VENDIM Nr.39

Ankuesi: Elvis Koçi

Kundër: Pamfleti.net

Titulli i artikullit objekt ankimi:

Kreu i 'Pastrimit të Parave' Elvis Koçi, makinë luksoze dhuratë nga një bankë mburojë e qarkullimit të parave të pista

Link-u i artikullit objekt ankimi:

<https://pamfleti.net/kreu-i-pastrimit-te-parave-elvis-koci-makine-luksoze-dhurate-nga-nje-banke-mburoje-e-qarkullimit-te-parave-te-pista/>

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI :

1. Artikulli ka shkelje etike në pjesën e tij të dytë, nuk mbështetet në bazë faktike dhe nuk është i verifikuar.
2. Fjalja në artikull, *"Pamfleti mëson se Elvis Koçi ka marrë një makinë luksoze dhuratë dhe ka raporte interesash me subjekte që janë objekt veprimit të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave"*, nuk është e faktuar apo argumentuar se i përket z.Koçi.
3. Në artikull nuk paraqitet asnjë përpjekje për të thelluar dyshimin dhe për të verifikuar se makina e përmendur është dhuratë për z.Koçi.

Bordi konstatoi se është shkelur përkatësisht Neni 1 i Kodit të Etikës së Gazetarit:

Neni 1. Saktësia e Informacionit " Gazetarët dhe mediat gjatë gjithë kohës duhet të përpiqen të botojnë informacionin që, në dijeninë e tyre, është i vërtetë, i balancuar dhe i verifikuar. Gazetari duhet të verifikojë informacionin përpara botimit me qëllim që të sigurohet që është i saktë, i bazuar në fakte dhe i besueshëm."

Për këto arsye, Bordi



Aleanca për
Media
Etike

VENDOSI

T'i rekomandojë medias online Pamfleti të përgënjeshtrojë artikullin ose të paraqesë faktet të cilat e vërtetojnë se makina e përmendur në artikull është dhuratë për z.Koçi.

Përgënjeshtrimi duhet bërë i qartë që në titull dhe më pas në përmbajtje, që informacioni mbi makinën e z.Koçi në artikullin paraardhës (objekt ankimi) dhënë me lidhje ose screenshot, nuk ka qenë i saktë.

Publikuar më 2 Gusht 2022